



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Sh. II.nr. 1623/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ndërmarrja Publike Banësore” Sh.a me seli në rrugën Zija Shemsiu nr.22 në Prishtinë kundër debitorit të përmbartimit “NAKI-TRADE” me seli në rr. Agim Ramadani nr. 22/65 në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1087/22 të datës 29.09.2023, me datë 04.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Ndërmarrja Publike Banësore” Sh.a ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1087/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1087/22 të datës 29.09.2023, në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit “NAKI-TRADE” me seli në Prishtinë, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr. 232/2021 të datës 22.07.2021 të përmbartueses private Saranda Rexhepi me seli në Prishtinë dhe është përfunduar në tërësi procedura përmbartimore në këtë çështje.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore si dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe

të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1087/22 të datës 29.09.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Ndërmarrja Publike Banesore” Sh.a me dt. 21.07.2021, ka paraqitur propozim për përmbirim , me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori i përmbirimit “NAKI-TRADE” me seli në Prishtinë që t’ia paguaj shumën prej 8,168.98€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbimore. Propozimin për përmbirim e kishte bazuar në ekstraktin e verifikuar nga librat e kontabilitetit të datës 05.07.2021 të lëshuara nga Kreditori dhe faturës 2021/1794 të datës 01.06.2021 të lëshuar nga Kreditori për Debitorin (këtu e tutje Fatura), të cilin ia ka bashkëngjitur Propozimit.

Përmbiruesi më 22.07.2021 e ka nxjerrë urdhrin përmbirimor P.nr.232/2021, me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbirimin sipas Propozimit.

Debitori më 13.12.2021 ka parashtruar prapësimin duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbirimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përmbirimor. Duke pretenduar se në Faturë nuk është e precizuar se çka duhet të paguhet, rrjedhimisht ajo nuk e ka përmbajrtjen sipas nenit 29 para. 3 të LPP-së. Po ashtu ka shtuar se Fatura nuk e përmban kohën e përmbushjes së detyrimit monetar. Prapësimi nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve lidhur me paraqitjen e prapësimi.

Kreditori në përgjigjen e tij në Prapësim ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar Prapësimi i Debitorit. Duke pretenduar se pretendimet e Debitorit janë të pabaza, meqë ky i fundit nuk ka paraqitur prova për ato dhe se nuk është provuar se ekziston ndonjëra nga bazat e nenit 71 të LPP-së. Sipas Kreditorit, ai ka vepruar në mbështetje të neni 329 para. 1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së sepse Fatura përmban vulën dhe nënshkrimin nga personi kompetent dhe se

kjo faturë e ka përmbajtjen e kërkuar me ligji. Për fund ka sqaruar se në Faturë është përshkruar borxhi mujor dhe shuma e përgjithshme e borxhit, dhe se në këtë çështje juridike kërkohet shuma e borxhit për periudhën kohore 01.07.2019-01.06.2021, sepse për pjesën tjetër të borxhit është iniciuar procedurë tjetër përmbartimore. Përgjigjes në prapësim ia ka bashkëngjitur propozimet tjera ndaj Debitorit, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1087/22 të datës 29.09.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit “NAKI-TRADE” me seli në Prishtinë, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr. 232/2021 të datës 22.07.2021 të përmbartueses private Saranda Rexhepi me seli në Prishtinë dhe është përfunduar në tërësi procedura përmbartimore në këtë çështje.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se kartela financiare lëndore e Kreditorit nuk mund të trajtohet si dokument i besueshëm, pasi ajo nuk ka të bëjë me shërbimet komunale për furnizimin me ujë, energji elektrike ose bartje të mbeturinave, por ka të bëjë me qiradhënien. Në anën tjetër, si ekstraktit (kartelës financiare) ashtu edhe faturës lëndore u mungojnë të dy format e përcaktimit të kohës për përmbushjen, gjegjësisht në ato nuk është caktuar koha e përmbushjes së detyrimit qoftë faqja 4 nga 4 në formë të afatit ose qoftë në formë të datës fikse, e as nuk është përcaktuar në formë të deklaratës lidhur me arritshmërinë e kërkesës, rrjedhimisht nuk është plotësuar kërkesa ligjore për tregimin e kohës së përmbushjes së detyrimit në dokumentin e besueshëm.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Shkallës së Dytë me shikim nga shkresat e lëndës ka vërejtur se në rastin konkret dokumenti i besueshëm- ekstrakti i verifikuar nga librat e kontabilitetit të datës 05.07.2021 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbaram, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Nagse sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarami me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaram po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbaram paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Prandaj, kartela financiare e datës 05.07.2021 nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm, pasi ajo nuk ka të bëjë me shërbimet komunale për furnizimin me ujë, energji elektrike ose bartje të mbeturinave, por ka të bëjë me qiradhënie. Ndërsa sa i përket faturës, 2021/1794 të datës 01.06.2021 nuk është caktuar koha e përmbushjes së detyrimit gjegjësisht nuk plotëson kushtet ligjore sipas dispozitave të LPP-së. Andaj, edhe dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi nuk ka arrit të argumentoj me prova juridikisht të vlefshme dhe se nuk kishin në ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbaramore dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbaramore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaramor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës

dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II nr.1623/23 me datë 04.04.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija- Ymeri